

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5828  
E martë, 16 korrik 2019  
çmimi 0.40 €

Universiteti i Prizrenit, i  
Pejës dhe i Mitrovicës këtë  
vit nuk mund të regjistrojnë  
studentë të rinj! FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRI I VENDIT, RAMUSH HARADINAJ, NUK KA NDRYSHUAR QËNDRIM SA I PËRKET TAKSËS 100 PËR QIND NDAJ PRODHIMEVE TË IMPORTUARA NGA SERBIA! FAQE 4

## Haradinaj: Taksa nuk hiqet pa njohje nga Serbia



Pavarësisht prej kërkesës së vazhdueshme të ndërkombëtarëve për heqjen e taksës për mallrat serbe, kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije të hënën se taksa nuk do të hiqet derisa Serbia ta njohë Republikën e Kosovës. Ai ka vlerësuar se, përveç tregut, Kosova nuk ka çfarë t'i japë më Serbisë. I pari i ekzekutivit ka deklaruar se nëse Kosova lëshon pe për taksën pa e marrë njohjen, faza finale e dialogut do të jetë e rrezikshme për Kosovën. Kryeministri Haradinaj ka treguar se presioni i jashtëm për heqjen e taksës po bëhet për ta disiplinuar Kosovën për fazën finale të dialogut

## Kosova merr kryesimin e SEECP-it

Republika e Kosovës të hënën zyrtarisht ka marrë kryesimin e nismës rajonale të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP). Me këtë rast, zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka bërë me dije se gjatë kryesimit

të SEECP-së vendi ynë prioritet do ta ketë promovimin e kulturës dhe artistëve të rinj, trashëgiminë kulturore, si dhe zhvillimet pozitive në sektorin e energjisë në rajon. Ai ka thënë se Kosova do t'i kontribuojë paqes, stabilitet dhe fqinjësisë së mirë FAQE 3



## Nënshkruhet marrëveshja që mundëson shkuarjen e mijëra infermierëve në Gjermani FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### OPINION

**FIZIKA  
SIMETRIKE,  
UDHËTIM DREJT  
UNIVERSIT** F. 11



Shkruan: Naim KRASNIQI,  
fizikan

### AKTUALE

**KUNDËRSHTOHET IDEJA E  
KORRIGJIMIT TË KUFIJVE** F. 5

**MUSTAFA NË TAKIM ME  
AMBASADORIN E NORVEGJISË  
FLET PËR ZGJEDHJET E  
PARAKOHSHME** F. 3

### EKONOMI



**FILLON ZBATIMI I LIGJIT  
PËR TRAJTIMIN E 352 MIJË  
NDËRTIMEVE PA LEJE** F. 9

**AKB-ja DHE DMPP-ja, ME  
MISIONARË TË PËRBASHKËT  
EKONOMIKË NË SHTATË SHTETE** F. 9

### KULTURË

**NËNSHKRUHET MARRËVESHJA  
PËR AFTËSIMIN E TË RINJVE  
NË TEKNOLOGJI INFORMATIKE  
DHE NDËRMARRËSI** F. 13

### SPORT

**FERONIKELI, GATI  
TA SHKRUAJË HISTORINË  
NË LIGËN E KAMPIONËVE** F. 16



## Macroni paralajmëron takim mes Kosovës dhe Serbisë

**BEOGRAD, 15 KORRIK** - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron tha të hënën në Beograd tha se dëshiron partneritet me Serbinë. "Kam ardhur për të kthyer një faqe të re në Serbi. Franca do që të ketë partneritet me Serbinë", tha ai në aeroportin "Nikola Tesla". Kurse Macroni tha se do të organizojë një takim mes liderëve të Kosovës dhe të Serbisë, bashkë me kancelaren gjermane, Angela Merkel.

"Ishim shumë të sigurtë në takim. Unë do të organizoj një takim me ju, me kryeministren serbe, me udhëheqjen e Kosovës dhe me kancelaren Merkel. Franca dëshiron që të arrihet marrëveshja. Serbia dhe Kosova janë shtete evropiane dhe dëshirojmë që kjo të kthehet në realitet", ka deklaruar Macroni. Ndërkaq, Aleksandar Vuçiq theksoi se ripërtëritja e miqësisë mes dy vendeve nuk do të kishte

sukses pa këmbënguljen, energjinë dhe dëshirën e Francës për t'u kthyer në këtë rajon. "Dua të falënderoj dhe të them se ky është vetëm fillimi i bashkëpunimit tonë të jashtëzakonshëm. Më lejoni t'ju falënderoj për besimin tuaj në Serbi, i cili i inkurajon investitorët tuaj që të vijnë në vendin tonë. Unë jam i nderuar që sot dhe nesër do t'ju pres në Beograd dhe Serbi", tha Vuçiq.



## Veseli takon kongresistin Connolly, diskutojnë për të ardhmen e Kosovës në NATO

Kongresisti amerikan Gerald E. Connolly në takim me kryeparlamentarin Kadri Veseli në Uashington, ka thënë se Kosova në të ardhmen e afërt duhet të jetë anëtare me të drejta të plota në NATO dhe BE dhe në këtë rrugëtim do ta keni mbështetjen e ShBA-së



"Kosova në të ardhmen e afërt duhet të jetë anëtare me të drejta të plota në NATO dhe BE dhe në këtë rrugëtim do ta keni mbështetjen e ShBA-së", ka deklaruar kongresisti Gerald E. Connolly.

Gjatë këtij takimi, Veseli e informoi kongresistin Connolly edhe për nismën e tij për formimin e Tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb të kryer në Kosovë, ide kjo e cila u mbështet nga kongresisti amerikan. "Të gjithë kriminelët e luftës duhet të përgjigjen para drejtësisë për krimet që kanë kryer ndaj civilëve të pafajshëm. Duhet të vijë drejtësia në vend për viktimat e luftës", ka thënë kongresisti Connolly.

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është prituri në Uashington në takim nga kongresisti Gerald E. Connolly, kryesues i delegacionit amerikan në Asambleenë Parlamentare të NATO-s dhe anëtar i Komisionit për Politikë të Jashtme në Kongresin amerikan.

Në këtë takim, kryeparlamentari Veseli e ka njoftuar kongresistin me zhvillimet politike në

Kosovë dhe rajon, ndërsa kanë diskutuar për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së.

Në 20 vjet liri që nga çlirimi, Veseli ka thënë se Kosova ka arritur progres në të gjitha fushat falë bashkëpunimit të ngushtë me aleatët e përherëshëm, ShBA-të dhe vendet mike perëndimore.

"Pas transformimit të FSK-së në ushtri, objektiv kryesor i Kosovës në fushën e sigurisë

është anëtarësimi i plotë në Aleancën Veri-atlantike, NATO", ka deklaruar Veseli. Nga ana e tij, kongresisti

amerikan ka shprehur mbështetjen e ShBA-së për hapat e mëtejshëm të rrugës euro-atlantike të Kosovës.

## SHBA-ja mund ta konsiderojë Maqedoninë e Veriut si partner në Ballkan

**SHKUP, 15 KORRIK** - Zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani mbajti takim me ambasadorin e sapoemëruar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Maqedoninë e Veriut, Kejt Mari Berns, në të cilin ka biseduar për integritet euroatlantike të vendit dhe përkrahjen e SHBA-së për anëtarësim të Maqedonisë së Veriut në NATO.



Zëvendëskryeministri Osmani, siç kanë informuar nga kabineti i tij, e uroi ambasadorin me rastin e emërimit të saj dhe i

dëshiroi punë të suksesshme, në drejtim të vazhimit të bashkëpunimit miqësor në kuadër të partneritetit strategjik mes dy vendeve, duke theksuar kënaqësi për mbështetjen nga ana e ShBA-së për aspiratat euro-atlantike të vendit, ka njoftuar zhurnal.

"ShBA-ja nuk është vetëm partner strategjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, por edhe mik i rëndësishëm, mbështetja e

të cilëve mund të vërehet në të gjithë sukseset e rëndësishme të vendit që nga pavarësia e saj", theksoi Osmani.

Ai potencoi se Maqedonia e Veriut mbetet partner i besueshëm i ShBA-së në Ballkan, fuqishëm përkushtuar në promovimin e vlerave perëndimore, demokracisë dhe stabilitetit në rajon.

Në takim Osmani dhe Berns diskutuan edhe për mbështetjen e ShBA-së për anëtarësimin e

Maqedonisë së Veriut në NATO, në pritje të ratifikimit të Protokollit për NATO nga ana e Senatit muajt e ardhshëm. Osmani theksoi edhe perspektivën evropiane të vendit, duke pasur parasysh se ndodhet në një periudhë të rëndësishme para marrjes së datës për fillimin e negociatave me BE-në në tetor të këtij viti, duke theksuar se mbështetja e ShBA-së është e rëndësishme së veçantë.

## Leyen, e përkushtuar për negociatat me Shqipërinë e Maqedoninë e Veriut

**STRASBURG, 15 KORRIK** - Kandidatja për presidente e Komisionit Evropian, ministrja gjermane e Mbrojtjes, Ursula von der Leyen deklaroi se mbetet e përkushtuar në fillimin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian të Shqipërisë dhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në përgjigjen e pyetjes së grupit të Aleancës Progresive të Socialistëve dhe Demokratëve (SD), në Parlamentin Evropian, Von der Leyen tha se "jam e përkushtuar në fillimin e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut për anëtarësim të ardhshëm në BE". "Ballkani Perëndimor duhet të

kuptohet më seriozisht", porositi Von der Leyen, që mbështet dyert e hapura drejt vendeve të Evropës Lindore dhe Ballkanit Perëndimor, që kërkojnë anëtarësim në BE. Ndërkohë, në një letër për social-demokratët, në vigjilje të votimit të sotëm (e martë) në Parlamentin Evropian për

zgjedhjen e saj në funksionin e presidentit të Komisionit Evropian, Von der Leyen tha se po planifikon të propozojë një pakt të ri të BE-së për migrimin dhe azilin.

"Na nevojitet mënyrë e re e risistemimit të ngarkesës. Na nevojitet edhe fillim i ri", tha Leyen.





Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka mbajtur konferencë për medie

# Kosova merr kryesimin e SEECP-it

Republika e Kosovës të hënën zyrtarisht ka marrë kryesimin e nismës rajonale të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP). Me këtë rast, zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka bërë me dije se gjatë kryesimit të SEECP-së vendi ynë prioritet do ta ketë promovimin e kulturës dhe artistëve të rinj, trashëgiminë kulturore, si dhe zhvillimet pozitive në sektorin e energjisë në rajon. Ai ka thënë se Kosova do t'i kontribuojë paqes, stabilitet dhe fqinjësisë së mirë

rajon dhe në harmoni të plotë me misionin kryesor të SEECP", është shprehur Pacolli, duke shtuar se politikat e BE-së për fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim rajonal do të prezantohen në mënyrën më të mirë të mundshme gjatë kryesimit të kësaj strukture të rëndësishme. "Kosova do të tregojë leadership rajonal në 12 muajt e ardhshëm duke promovuar një klimë më të mirë për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, në të njëjtën kohë do të tregojmë se sa politikisht korrekt duhet të veprojmë në rajon me qëllim të forcimit të së ardhmes evropiane të Ballkanit Perëndimor. Kosova do të promovojë aktivitete të ndryshme dhe do të presë shumë takime të nivelit të lartë gjatë kryesimit", është shprehur zëvendëskryeministri Pacolli. Sipas Pacollit, gjatë kryesimit të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore nga Kosova politika e BE-së për fqinjësi të mirë do të prezantohet në mënyrën më të

mirë të mundshme. Në këtë kontekst, ai ka bërë me dije se synimi kryesor mbetet integrimi në Bashkimin Evropian. Megjithatë, ministri Pacolli ka thënë se është i vetëdijshëm për sfidat që ndodhen në rrugën përpara për shkak të marrëdhënieve me disa prej shteteve anëtare. "Kosova është e përkushtuar të jetë një partnere kredibile dhe konstruktive në rajon dhe në harmoni të plotë me misionin kryesor të SEECP-së. Politika e BE-së për fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim rajonal do të prezantohet në mënyrën më të mirë të mundshme gjatë kryesimit tonë të kësaj strukture të rëndësishme", ka theksuar ai. Pacolli ka treguar nëse Kosova do t'ua ndalojë hyrjen zyrtarëve serbë që do të vijnë në kuadër të SEECP-së. "Në Kosovë do të jetë i mirëardhur çdo mik dhe çdokush që dëshiron të vijë e ta vizitojë Kosovën, të punojë me Kosovën. Por, Kosova do të jetë e mbyllur për çdokënd që vjen me tentativë që ta çakordojë har-

moninë ndëretnike, të cilën ne e kemi krijuar dhe për ne paraqet një simbol të shenjtë që është i mbrojtur me të gjitha ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës", ka deklaruar Pacolli. Ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, është shprehur pesimist sa i përket mundësisë që liberalizimi i vizave të ndodhë sivjet. Pavarësisht prej insistimit të gazetarëve për të dhënë një afat kohor, Pacolli nuk ka thënë se kur do të jepet drita e gjelbër që qytetarët e Kosovës të udhëtojnë lirshëm në Zonën Shengen. "Mos më bëni të premtoj asgjë. Unë me vullnet do t'ju thosha 'nesër'. Por, nuk mund t'ju them. Jemi duke punuar, jemi në rrugë të mirë për këtë", ka theksuar ai. Vendet anëtare të SEECP janë Kosova, Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Turqia, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Sllovenia, Bullgaria, Greqia, Moldavia dhe Rumania.

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 15 KORRIK - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, të hënën në një konferencë për medie ka hapur solemnisht kryesimin e Republikës së Kosovës në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP). Të pranishëm në këtë ceremoni kanë qenë ambasadorët e disa prej vendeve anëtare të nismës rajonale të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore. Me këtë rast, ministri Pacolli ka vlerësuar se Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore nën kryesimin e Kosovës do të zhvillohet më tej si një shprehje e solidaritetit dhe përpjekjeve të shteteve pjesëmarrëse për t'i forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin midis tyre dhe shteteve e strukturave të tjera euroatlantike.

Ai u ka bërë me dije të pranishmëve se prioritetet e Republikës së Kosovës do të jenë promovimi i kulturës dhe artistëve të rinj, trashëgimia kulturore, si dhe zhvillimet pozitive në sektorin e energjisë në rajon. "Kosova synon të kontribuojë më tutje për një mjedis të paqes, sigurisë, marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe stabilitetit, duke kapërcyer ndarjet përmes një qasje gjithëpërfshirëse dhe koherente, ndaj bashkëpunimit rajonal dhe duke promovuar integrimin evropian", ka deklaruar Pacolli. Ministri Pacolli ka folur edhe

për ngjarjet e fundit para dhe gjatë Samitit në Sarajevë, ku pozita e Kosovës në kuadër të SEECP nuk është respektuar dhe Kosova nuk është trajtuar si të gjitha shtetet e tjera anëtare. "Kjo mund të ishte shmangur me një vullnet të mirë politik dhe koordinim mes shteteve. Megjithatë, Kosova është e përkushtuar të jetë një partnere kredibile dhe konstruktive në



## Mustafa në takim me ambasadorin e Norvegjisë flet për zgjedhjet e parakohshme



PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, në një takim lamtumirës ka mirëpritur të hënën ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad. "Gjatë takimit u diskutua për situatën aktuale në vend,

zgjedhjet e parakohshme dhe zgjedhjet e brendshme të LDK-së. Kryetari Mustafa e falënderoi ambasadorin Sjaastad për përkushtimin dhe angazhimin e tij në zhvillimin e Kosovës dhe Norvegjinë për mbështetjen që i ka dhënë vendit", është

thënë në njoftimin e LDK-së. Sipas këtij njoftimi, ambasadori Sjaastad e ka falënderuar Mustafën për pritjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës për një shtet zhvillimor.



Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, nuk ka ndryshuar qëndrim sa i përket taksës 100 për qind ndaj

# Haradinaj: Taksa nuk hiqet pa njoh



Pavarësisht prej kërkesës së vazhdueshme të ndërkombëtarëve për heqjen e taksës për mallrat serbe, kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije të hënën se taksa nuk do të hiqet derisa Serbia ta njohë Republikën e Kosovës. Ai ka vlerësuar se, përveç tregut, Kosova nuk ka çfarë t'i japë më Serbisë. I pari i ekzekutivit ka deklaruar se nëse Kosova lëshon pe për taksën pa e marrë njohjen, faza finale e dialogut do të jetë e rrezikshme për Kosovën. Kryeministri Haradinaj ka treguar se presioni i jashtëm për heqjen e taksës po bëhet për ta disiplinuar Kosovën për fazën finale të dialogut

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përsëritur qëndrimin e tij se taksa ndaj mallrave serbe nuk do të hiqet pa e njohur Serbia Kosovën. Pavarësisht prej kërkesës së vazhdueshme të ndërkombëtarëve që të hiqet taksa dhe t'i hapet rruga dialogut Kosovë - Serbi, Haradinaj ka thënë se Kosova nuk duhet të bëjë hapa prapa në këtë drejtim. Gjatë një vizite në Komunën e

Vushtrrisë, kryeministri Haradinaj ka treguar se pse po i bëhet Kosovës presion në këtë fazë për heqjen e taksës. "E vërteta është se kërkesa për pezullim të taksës ekziston. Unë mendoj se është një kërkesë që të na disiplinojë, që ne të pranojmë ndonjë zgjidhje me më shumë kompromise në marrëveshjen finale me Serbinë. Prej nesh nuk ka mbetur shumë se çka të japim", ka thënë Haradinaj. I pari i qeverisë ka vlerësuar se taksa ndaj Serbisë është kriter për matjen e shtetësisë së Kosovës.

Sipas Haradinajt, nëse shteti i Kosovës bënë lëshime në këtë fazë atëherë do ta ketë më të vështirë në marrëveshjen finale. "Ne jemi pajtuar me Ahtisaarin, i kemi kryer ato obligime që i kemi pasur. Tani nuk kemi se çfarë të japim për njohjen, por mund ta japim një partner ekonomik për Serbinë, sepse kur të na njohë Serbia, hiqet edhe taksa. Për mua taksa nuk është vetëm taksë dhe tregti, por është edhe kriter se a jemi shtet a jo. Nëse ne lëshojmë pe për taksën para njohjes atëherë do ta kemi më vështirë një



prodhimeve të importuara nga Serbia

## je nga Serbia



tona. Kuptohet që marrëdhëniet Francë - Serbi ata i kanë me rëndësi, por raporti i tyre nuk i ndryshon raportet tona", është shprehur ai, duke shtuar se Kosova nuk duhet të bëjë asnjë hap prapa në raport me taksën. "Mirë është që gjithë rajoni ynë të anëtarësohet drejt BE-së. E them edhe një herë se Kosova nuk është mirë të japë shembuj të dobësimit, dorëzimit dhe nënshtrimit në etapën finale. Nëse japim një shembull të tillë, kërkesat kanë për t'u rritur për kompromise më të mëdha në fund. Po e përsëris edhe një herë, si ta na njohë Serbia ne e heqim taksën", ka thënë Haradinaj.

Vendet e Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës pezullimin e taksës ndaj produkteve të Serbisë në mënyrë që të rifillojë dialogu, por kryeministri Haradinaj në vazhdimësi ka ripërsëritur se taksë nuk do të hiqet pa njohjen e shtetit të Kosovës nga ana e Serbisë. "Derisa tarifa që ua ka vënë Prishtina mallrave të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina mbetet në fuqi, nuk shoh kushte për thirrjen e dialogut në nivel të lartë", ka thënë para disa ditësh përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini.

### TAKSA NUK NDËRLIDHET ME LIBERALIZIM TË VIZAVE

Kreu i ekzekutivit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se heqja e taksës nuk ndërlidhet me procesin e liberalizimit të vizave. Ai edhe një herë ka treguar se liberalizimi i vizave për Kosovën nuk është larg, duke shtuar se këtë çështje e ka diskutuar edhe me ministrin gjerman të Shëndetësisë, Jens Spahn, i cili të hënën e ka vizuar Kosovën. "Ju siguroj se vizat nuk i kemi larg për t'i marrë. Sot kemi pasur për vizitë ministrin e Shëndetësisë së Gjermanisë, Jens Spahn, me të cilin kam biseduar edhe për këtë temë. Jemi në punë dhe nuk është larg dita e marrjes së vendimit për vizat. Pra, kjo temë nuk është e lidhur me taksën", ka thënë kryeministri Haradinaj.

marrëveshje në pozicione të barabarta", është shprehur ai. Kryeministri i vendit e ka komentuar edhe vizitën e presidentit të Francës, Emanuel Macron, në Serbi, duke thënë se kjo vizitë nuk do të ndikojë në raportet e mira Kosovë - Francë. "Unë kam pasur një bisedë telefonike me këshilltarin e lartë të presidentit francez para kësaj vizite. Na është sqaruar vizita dhe qëllimi i vizitës së Macronit. Franca e ka njohur Kosovën shtet sovran, në territorin e vet, në kufijtë e vet dhe ka këtë qëndrim sa i përket marrëdhënies

## Kundërshtohet ideja e korrigjimit të kufijve

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

ÇAGLLAVICË, 15 KORRIK - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të hënën tryezën e diskutimit "E ardhmja e raporteve Kosovë - Serbi nga perspektiva e qytetarëve në Kosovë". Në këtë diskutim morën pjesë deputeti Dukagjin Gorani, ish-deputetja Rada Trajkoviq, zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Anton Berisha, si dhe ish-ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq.

Në hapjen e tryezës Jeta Krasniqi nga KDI ka theksuar nevojën për përfshirjen e qytetarëve në diskutimet që ndërlidhen me të ardhmen e dialogut dhe procesin e normalizimit. Ajo ka thënë se nga fillimi ky proces ka qenë jotrashant dhe ka munguar përfshirja e qytetarëve.

Dialogu aktualisht mbetet i pezulluar për shkak të kushtëzimit të Serbisë për heqjen e taksës ndaj produkteve të Serbisë nga Qeveria e Kosovës. Ndërsa spektri politik ende nuk ka arritur ta ndërtojë konsensusin e nevojshëm politik për të pasur qëndrim unik në këtë proces.

Deputeti Dukagjin Gorani fillimisht ka theksuar se procesi i dialogut nuk ka sjellë rezultatet e pritura. Ai ka shprehur shqetësimin që çështja Kosovë - Serbi po diskutohet si problem në mes të shqiptarëve dhe serbëve. "Në vend se të flitet për komunitete, aktualisht po flitet për territore. Por, edhe kur flitet për territore, flitet vetëm për pjesën veriore të vendit. Në tërë procesin mungojnë serbët e Kosovës si komunitet, veçanërisht ata që quhen 'serbët e jugut', të cilët kanë qenë dhe mbeten të papërfaqësuar në këtë proces", ka thënë ai. Gorani ka theksuar se arkitektura institucionale në

vend nuk ofron hapësirë për zgjidhje inovative për çështjet e interesit nacional, andaj nëse palët duan zgjidhje, duhet ta reformojnë mendësinë dhe kushtetutën. Deputeti Gorani, duke folur për idenë për korrigjimin e kufijve, tha se "ndarja e kufirit do të jetë zgjidhje në mungesë të zgjidhjes.

Ish-deputetja Rada Trajkoviq ka thënë se rezultati i bisedimeve Kosovë - Serbi deri më tani më së shumti i ka goditur serbët e Kosovës pasi, siç tha ajo, "është diskutuar në përgjithësi për integrimin e veriut, por diskutimet i kanë prekur të gjithë serbët e Kosovës". Sipas saj, serbët janë harruar nga shteti i Serbisë, ndërsa institucionet e Prishtinës nuk punojnë për mbështetjen e mbijetesës së serbëve.

Trajkoviqi ka thënë se përfaqëson grupin e njerëzve të cilët janë kundër ndarjes së Kosovës si zgjidhje potenciale në mes palëve, duke shtuar se kjo zgjidhje do të sillte destabilitet.

Ish-deputetja Trajkoviq ka vlerësuar se pajtimi mes dy shoqërive duhet të fillojë me dënimin e kriminelëve të luftës, të cilët akuzohen për kryerjen e krimeve të luftës. Kurse sa i përket idesë së korrigjimit të kufijve, ajo u shpreh që "nuk është hequr dorë nga kjo ide përderisa presidentë të të dyja vendeve janë Thaçi dhe Vuçiqi".

Zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Anton Berisha, ka thënë se të dy shtetet duhet të synojnë paqen dhe jo zgjidhje të bazuar në territore. Ai ka thënë se është e domosdoshme që koncepti qytetar të dominojë këtë diskurs, ndërsa ka shtuar se secili qytetar i Kosovës duhet ta ndiejë Kosovën si shtet të vetin.

Lidhur me procesin e dialogut, Berisha ka theksuar se një proces pa fokus dhe datë mund të vazhdojë me dekada të tëra. Ai ka shtuar se qëndrimi i qeverisë

është që "dialogu me Serbinë duhet të përfundojë, të afatizohet dhe duhet të përmbillet me njohje reciproke në mes dy shteteve dhe më pas të diskutohet për çështje të ndryshme ndërshtetërore". Ai i ka dënuar të gjitha aktet e dhunës ndaj qytetarëve, varrezave dhe dinjitetit të qytetarëve serbë të Kosovës.

Në anën tjetër, ish-ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, duke folur në përgjithësi për procesin e dialogut, ka vlerësuar se ka pasur organizim dhe menaxhim të keq të tij. Ai kundërshtoi idetë rreth korrigjimit të kufijve dhe ndarjes së Kosovës, duke i cilësuar si ide katastrofike. Sa i përket rolit të serbëve të Kosovës në procesin e normalizimit, sidomos serbëve që jetojnë në jug, Rashiq ka theksuar që "serbët përdoren si mekanizëm nga Beogradi, përkatësisht nga struktura në pushtet atje, për tregti politike". Ai ka potencuar që asnjë zgjidhje nuk duhet të arrihet pa përfshirjen e serbëve të Kosovës si dhe ka kërkuar që të ndërpritet strategjia e shpërnguljes së tyre nga Kosova.

Të pranishmit e tjerë në këtë diskutim ngritën pyetje dhe shqetësime lidhur me praninë e idesë për korrigjimin e kufijve në bisedimet mes palëve, përkatësisht të pasojave eventuale që kjo zgjidhje do të kishte për serbët që jetojnë në jug të lumit Ibër, kthimin e serbëve të shpërngulur nga Kosova si dhe veprimet e institucioneve për garantimin e jetesës dhe interesave së përbashkëta të shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë.

Ky diskutim u organizua në kuadër të projektit "Perspektiva evropiane - ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënies me Serbinë" që përkrahet nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.





# Universiteti i Prizrenit, i Pejës dhe i Mitrovicës këtë vit nuk mund të regjistrojnë studentë të rinj

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) ka vendosur të hënën në favor të ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët kanë rekomanduar për heqjen e akreditimit institucional për vitin akademik 2019/2020 të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", atij të Pejës "Haxhi Zeka" dhe të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini". Po sipas KShC-së, kolegji Fama, Iliria, Tempulli dhe Kosova Art Academy nuk kanë të drejtë këtë vit që të pranojnë studentë të rinj



Kolegji Biznesi dhe Juridica nuk automatizëm nënkupton njoftimin e ORCA-së, organizatë kanë aplikuar fare, çka me mosakreditim", është thënë në monitoruese e KShC-së.

## Haradinaj: Vendimi i KShC-së për mospranimin e studentëve të rinj në tri universitetet publike, i papranueshëm

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) për mospranimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2019/2020 në tri universitete publike. Ai ka thënë se është i papranueshëm vendimi për mbylljen e Universitetit të

Pejës, Mitrovicës dhe Prizrenit. Haradinaj ka paralajmëruar se do të veprohet menjëherë duke ndërmarrë hapa konkretë për zgjidhjen e kësaj situate. "Është i papranueshëm vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë për mbylljen e tri universiteteve publike: atij në Pejë, në Mitrovicë dhe në Prizren. Si

kryeministër i vendit e konsideroj të padrejtë mohimin e mundësisë për regjistrim të studentëve, duke ua humbur atyre vitin. Ndaj këtij rasti do të veprojmë menjëherë, duke ndërmarrë hapa konkretë për zgjidhjen e kësaj situate", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

EPOKA E Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 KORRIK - Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) ka vendosur të hënën në favor të ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët kanë rekomanduar për heqjen e akreditimit institucional për vitin akademik 2019/2020 të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", atij të Pejës "Haxhi Zeka" dhe Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini". Një vendim i tillë i KShC-së u pamundëson këtyre universiteteve të pranojnë studentë të rinj, ani pse të këto universitete kanë hapur konkurset për pranimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2019/2020.

Unioni i Studentëve Shqiptarë (USSh) ka dalë kundër vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) për tërheqjen e akreditimit për vitin 2019/20 për tri universitetet publike. "Pas vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) për tërheqjen e akreditimit për vitin akademik 2019/2020, Unioni i Studentëve Shqiptarë në Pejë

deklaror se ky vendim është jo i favorshëm. Do ta takojmë menaxhmentin e universiteteve publike për të kërkuar informata shtesë mbi procesin e akreditimit. Nuk do të lejojmë të keqpërdoret e të luhet me djersën e studentëve. Nëse konkludojmë se ka pasur parregullsi në këtë vendim, në afat të shkurtër kohor do të mobilizohemi për protesta studentore. Unioni i Studentëve Shqiptarë është i thirrur për t'i udhëhequr studentët drejt duke mos lejuar cenimin e të drejtave", është thënë në reagimin e USSH-së. Po ashtu, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) ka vendosur të hënën në favor të ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët kanë rekomanduar për heqjen e akreditimit institucional për vitin akademik 2019/2020 edhe për katër kolegje private.

Kolegji Fama, Iliria, Tempulli dhe Kosova Art Academy nuk kanë të drejtë këtë vit që të pranojnë studentë të rinj. "KShC-ja, po ashtu, sot nuk u ka dhënë akreditim disa institucioneve private si FAMA, Iliria, Tempulli dhe Kosova Art Academy, ndërsa

## Nënshkruhet marrëveshja për aftësimin e të rinjve në teknologji informatike dhe ndërmarrësi

EPOKA E Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 KORRIK - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të hënën në kabinetin e vet drejtorin e Zyrës në Kosovë të Institutit për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Bashkësisë së Shkollave të Larta Popullore Gjermane (DVV International), Ramadan Alija. Në këtë takim në mes të Ministrisë dhe Institutit u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të implementimit të projektit "Ngritja e aftësive dhe kompetencave të të rinjve në fushën e teknologjisë informatike dhe ndërmarrësisë nga tri rajone të Kosovës (Ferizaj, Malishevë dhe



Viti). Ministri Gashi ka bërë me dije se për realizimin e këtij projekti MKRS-ja merr përsipër që të investojë me 11 mijë euro duke siguruar furnizimin me pajisje të nevojshme të së paku dy punë-

torive për teknologji informatike dhe ndërmarrësi në dy qendra rinore. "Me DVV International, Zyra në Kosovë, jemi pajtuar që të bashkëpunojmë në fushën e arsimimit të rinisë kosovare përmes arsimit joformal, duke

përfshirë tri qendra rinore nga tri rajone të ndryshme të Kosovës, si struktura organizative të MKRS-së dhe kjo duke pasur parasysh faktin se arsimimi i rinisë dhe përfitimi i njohurive në fushën e teknologjisë informatike dhe ndërmarrësisë ndikon në nxitjen e punësimit, pjesëmarrjen e rinisë në zhvillimin kulturor, shoqëror, ekonomik dhe të qëndrueshëm si dhe në uljen e varfërisë", ka theksuar ministri Gashi. Ai ka thënë se objektivë kryesorë e këtij projekti është aftësimi i së paku 100 personave në vit me qëllim të zbutjes së papunësisë dhe krijimit të mundësive për hapjen e bizneseve të vogla dhe vetëpunësimit të rinisë. Ramadan Alija, drejtor i Zyrës në

Kosovë i këtij instituti, falënderoi ministrin Gashi për pritjen e tij dhe nënshkrimin e marrëveshjes. "Projekti në fjalë në mënyrë specifike do ta përfshijë ngritjen e vetëdijes për themelimin e biznesit te personat që do të marrin pjesë në trajnim, ngritjen e aftësive, shkathtësive dhe kompetencave të tyre në fushën e teknologjisë informatike dhe ndërmarrësisë dhe punësimin apo vetëpunësimin e kandidatëve pas vijimit të trajnimeve", ka thënë Alija. Ai ka shtuar se pret që realizimi i këtij projekti të rezultojë i suksesshëm dhe se bashkëpunimi me ministrin të vazhdojë edhe në të ardhmen me projekte të tjera në të mirë të rinisë.



Ministri i Shëndetësisë i Gjermanisë, Jens Spahn, ka qëndruar për vizitë në Republikën e Kosovës

# Nënshkruhet marrëveshja që mundëson shkuarjen e mijëra infermierëve në Gjermani

Kosova dhe Gjermania kanë nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë. Nënshkrimi i marrëveshjes është bërë të hënën në Prishtinë nga ministri i Shëndetësisë i Kosovës, Uran Ismaili dhe ministri i Shëndetësisë i Gjermanisë, Jens Spahn. Me anë të kësaj marrëveshje Gjermania do ta ndihmojë Kosovën për krijimin e një sistemi modern shëndetësor. Po ashtu, kjo marrëveshje parasheh edhe shkuarjen e mijëra infermierëve kosovarë në Gjermani

pikë referente pasi që Gjermania është shembulli i duhur që duhet të ndjekim. Përpos sigurimeve shëndetësore, vëmendje e veçantë do t'u kushtohet edhe trajnimeve të profesionistëve shëndetësorë si dhe rritjes së kapaciteteve menaxheriale në spitalet tona përmes asistimit të ekspertëve gjermanë. Sot është një ditë historike për Kosovën për faktin se kemi një zotim të Gjermanisë se do ta ndihmojnë shëndetësinë e Kosovës. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje është një hap i ri për të krijuar një sistem modern shëndetësor në vend. Qëllimi i Kosovës mbetet që të marrë praktika më të mira evropiane", ka deklaruar ministri Ismaili.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë i Gjermanisë, Jens Spahn, ka deklaruar se Kosova dhe Gjermania kanë mundësi të mira të bashkëpunimit, pasi Gjermania ka numër më të madh të qytetarëve të vjetër, kurse Kosova ka të rinj. Ai ka theksuar se kjo marrëveshje mund të shërbejë si bazë për

shkarjen e mijëra infermierëve kosovarë në Gjermani. "Ne kemi nevojë për rreth 70 mijë infermierë. Këtë numër të madh të infermierëve që na duhen mund ta arrijmë vetëm me ardhjet nga vendet e tjera dhe Kosova është shteti i parë me të cilën nënshkruam marrëveshje të kësaj natyre", ka deklaruar Spahn, duke shtuar se Gjermania ka një ekspertizë më shumë se 125-vjeçare dhe dëshiron ta ndihmojë Kosovën me përvojat në përkrahje dhe këshillim. "Në anën tjetër kemi edhe fushat se ku mund të ndihmojmë, si kualifikimi dhe certifikimi në fushën e infermierisë. Diplomat e infermierisë do të ishte mirë të njiheshin më lehtë në Gjermani. Gjermania ka nevojë për ardhje të ekspertëve të fushës së infermierisë. Për këtë arsye, jam i lumtur që kemi krijuar një bazë të përbashkët. Një qëllim yni është shkollimi profesional nëpër shkolla, i cili i referohet standardit gjerman. Gjithashtu, sot për së afërmi kam parë edhe procedurat e vizave dhe duhet ta

shohim përshpejtimin e marrjes së vizës për infermierët", është shprehur ai.

Ministri gjerman ka bërë me dije se do të ketë këmbim dhe përkrahje në fushën e sigurimit shëndetësor. "Unë kam dëgjuar se do të mund të ketë përkrahje në praktike në fushën e sigurimit shëndetësor. Po ashtu, shtrohet pyetja, në rast të një situatë emergjente, kur një person nuk është në gjendje t'i mbulojë shpenzimet financiare, atëherë do t'i ofrohet ndihma", ka thënë ministri Spahn.

Gjithashtu, në kuadër të vizitës së tij në Kosovë ministri gjerman është pritur në takim edhe nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se Gjermania është një nga vendet që ka dhënë më së shumti kontribut për pavarësinë e vendit dhe në procesin e shtetndërtimit. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për ta fuqizuar këtë marrëdhënie duke e konsideruar shtetin gjerman partner serioz dhe afatgjatë në të gjitha fushat.

Kryeministri Haradinaj e ka njoftuar ministrin Spahn për zhvillimet e fundit në vend duke vënë theks në përparimet në fushën e shëndetësisë. "Qeveria e Kosovës me të drejtë e ka rritur rreth 20 për qind buxhetin për shëndetësinë, në të gjitha nivelet e saj për vitin 2019, si përpjekje për ta përmirësuar këtë sektor dhe për t'i përmirësuar shërbimet në fushën e mjekësisë dhe shëndetësia është ndër sektorët me prioritet në vend dhe në këtë drejtim do ta vazhdojmë angazhimin tonë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se në këtë rrugëtim partnerët si Gjermania janë tejet të rëndësishëm. "Kosova ka kapacitete për të ofruar shërbime shëndetësore dhe përcjellëse edhe për Gjermaninë. Ne kemi qenë dëshmitarë që ekspertët tanë tashmë kanë shënuar rezultate dhe suksese në Gjermani dhe vende të tjera, po ajo çka mund të bëjmë është, bashkëpunimi konkret, që nga këtu, me ekspertë tanë, t'i ofrojmë këto shërbime për Gjermaninë dhe ky lloj partneriteti do të jetë në interes të të dyja palëve", ka theksuar Haradinaj.

**EPOKA  
ERE** **Faton DERMAKU**

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - Ministri i Shëndetësisë i Gjermanisë, Jens Spahn dhe ministri i Shëndetësisë i Kosovës, Uran Ismaili, të hënën në Prishtinë kanë nënshkruar marrëveshjen e parë në fushën e shëndetësisë ndërmjet dy vendeve. Marrëveshja parasheh krijimin e një sistemi modern shëndetësor në Kosovë dhe shkuarjen e mijëra infermierëve kosovarë në Gjermani.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se nënshkrimi i kësaj marrëveshje është pjesë e reformave që po bëhen në shëndetësi. Sipas tij, marrëdhëniet miqësore mes dy vendeve tani do të jenë edhe më të forta dhe qytetarët kosovarë do të përfitojnë më së shumti. "Deri më sot Kosova asnjëherë nuk ka pasur në krahë të saj një shtet kaq të fuqishëm botëror për të na ndihmuar në jetësimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. E kam përzgjedhur pikërisht Gjermaninë si shtet model dhe



## Filloi asfaltimi i segmentit të pestë të rrugës Besi - Podujevë

**PRISHTINË, 15 KORRIK (ER)** - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka njoftuar të hënën se ka filluar asfaltimi i segmentit

të pestë të rrugës Besi - Podujevë, i gjatë mbi 4.2 kilometra dhe është pjesë e projektit "Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, rrethro-

tullimi Besi - Podujevë". Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka kërkuar mirëkuptimin e qytetarëve për shkak të

pengesave që mund të hasin gjatë asfaltimit të këtij segmenti, i cili do të përfundojë gjatë ditëve në vijim.





## MBPZhR-ja dhe UNDP-i bashkëpunojnë për përkrahjen e grave fermere



PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Ministri e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Ziviq, ka takuar të hënën përfaqësuesen kryesore të UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko, me të cilën ka biseduar për bashkëpunimin e deritanishëm mes dy institucioneve si dhe

për projektet e shumta të cilat pritet të realizohen në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ministri Ziviq e ka njoftuar atë për investimet e MBPZhR-së që do të realizohen gjatë këtij viti në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe për të gjitha projektet e

tjera që për qëllim kanë fuqizimin e sektorit të bujqësisë në vend. Ndër të tjera, ministri Ziviq ka folur për rëndësinë e bashkëpunimit të mëtejshëm me qëllim të mbështetjes së grave fermerë, veçanërisht të atyre në zonat rurale. "Ofrimi i

mbështetjes për gratë në zonat rurale është një hap i rëndësishëm drejt pavarësisë së tyre dhe për ta rritur cilësinë e jetës së tyre dhe konsideroj se ndihma është e nevojshme për t'i certifikuar prodhimet e tyre, duke ua lehtësuar kështu marketingun për produktet e tyre

bujqësore", ka thënë Ziviq. Përfaqësuesja kryesore e UNDP-së, Maria Suokko, ka theksuar rëndësinë për mbështetjen e grave fermere, duke shtuar me këtë rast se, krahas kësaj, do të vazhdojnë ta mbështesin sektorin e bujqësisë për ngritjen e kapaciteteve.

## Përfaqësuesit e sektorit të përpunimit të metalit dhe drurit takohen me kryeministrin



PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim përfaqësues të sektorit të përpunimit të metalit dhe drurit, për t'i dëgjuar nga afër disa kërkesa të tyre, në mënyrë më specifike çështjen e inicimit të një marrëveshjeje

bilaterale për transferim të fuqisë punëtore me Gjermaninë. Përfaqësuesit e sektorit të përpunimit të metalit dhe drurit e kanë njoftuar kryeministrin Haradinaj për veprimtarinë e tyre dhe angazhimet që ka ky sektor, duke thënë se shumë kompani përpunuese të metalit në Kosovë

eksportojnë në Gjermani, bazuar në marrëveshjet B2B që i kanë me kompanitë gjermane. "Bizneset kosovare momentalisht kanë të hapura edhe përfaqësi në Gjermani, por kanë probleme me fuqinë punëtore që nuk mund ta transferojnë atje. Përfitimet janë të shumëfishta të kompanive

kosovare, por edhe të Qeverisë së Kosovës nëse do të mund të lidhet kjo marrëveshje", i thanë kryeministrin Haradinaj përfaqësuesit e sektorit të përpunimit të metalit dhe drurit në këtë takim. Kryeministri Haradinaj ka falënderuar të pranishmit për vizitën dhe për t'i shprehur

kërkesat e tyre në të mirën e përbashkët, derisa u zotua se do të angazhohet që shqetësimet e tyre të marrin vëmendjen e merituar dhe qeveria do ta mbështesë Qendrën për Aftësim Profesional sipas modelit gjerman të mësimi dual.

## PSD-ja kërkon qasje në dokumentacionin për Termocentralin 'Kosova e Re'

PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Partia Socialdemokrate (PSD) konsideron se procesi i ndërtimit të Termocentralit "Kosova e Re" vazhdon të përcillet nga mungesa e transparencës. Sipas një reagimi të bërë përmes faqes zyrtare në "Facebook", PSD-ja vë në pah faktin se së fundi "Balkan

Green Foundation", "Instituti GAP", Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Instituti për Politika Zhvillimore, të cilat me plot vëmendje e kanë përcjellë procesin e ndërtimit të TC "Kosova e Re" për vite me radhë, kanë shprehur shqetësimin pasi që iu është refuzuar qasja në

dokumentet që lidhen me këtë proces. Për këtë kjo parti ka bërë me dije se grupi parlamentar i Partisë Socialdemokrate përmes deputetit Dardan Sejdiu, të hënën ka nisur në adresë të kryeministrin Ramush Haradinaj dhe ministrit të Zhvillimit

Ekonomik, Valdrin Lluka, kërkesë për zbatim të Aktgjykimit A.nr. 318/17 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për lejimin e qasjes në dokumentacionin për Termocentralin "Kosova e Re". "Moslejimi i qasjes në këto dokumente përbën degradim dhe ngushtim të vëllimit të lirisë



së qasjes në informata të garantuara edhe me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike", thuhet në reagimin e PSD-së.



# Fillon zbatimi i ligjit për trajtimin e 352 mijë ndërtimeve pa leje

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se nga dita e hënë ka filluar zbatimi i ligjit për trajtimin e 352 mijë ndërtimeve pa leje, ku pjesë më e madhe e tyre bën pjesë në kategoritë 1 dhe 2, e për të cilat përgjegjëse është niveli lokal, kurse për kategorinë 3 përgjegjëse për procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje është MMPH-ja



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 KORRIK - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, së bashku me sekretarin, Arben Çitaku dhe drejtorin e Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim, Servet Spahiu, kanë mbajtur të hënë konferencë për media, në të cilën kanë shpalosur Udhëzimet Administrative që dalin nga Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje. Me këtë rast, ministri Matoshi ka thënë se Ministria e Mjedisit ka hartuar pesë udhëzime administrative të cilat rregullojnë aspekte të veçanta të procesit të trajtimit të ndërtimeve pa leje në vendin tonë. "Pra, nga sot fillon edhe zbatimi i ligjit për trajtimin e 352 mijë ndërtimeve pa leje, ku pjesë më e madhe e tyre bën pjesë në kategoritë 1 dhe 2, e për të cilat përgjegjëse është niveli lokal, kurse për kategor-

inë 3 përgjegjëse për procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje është MMPH-ja", ka deklaruar ministri Matoshi.

Ministri Matoshi ka thënë se me fuqizimin e këtyre udhëzimeve administrative është kompletuar në tërësi infrastruktura ligjore e për trajtimin e Ligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje. "Pra, me zbatimin e këtij ligji dhe udhëzimeve administrative do të kemi një numër dukshëm më të madh të objekteve të legalizuara gjithandej territorit të Kosovës", ka thënë ministri Matoshi.

I pari i MMPH-së, Matoshi, ka treguar se me këto udhëzime do të ketë taksa më të lira, ku për kategorinë e parë do të jetë një euro për metër katror, ndërsa për kategorinë e dytë do të jetë taksa 2 euro për metër katror. Pas hyrjes në fuqi të këtyre udhëzimeve, ministri Matoshi tha se do të ketë takime me kryetarët e komunave dhe drejtorive përkatëse si

dhe do të ketë një fushatë informuese për qytetarët e Kosovës për këtë proces.

Ministri Matoshi ka falënderuar donatorët ndërkombëtarë: USAID-in, GIZ-in, UN-HABITAT-in, OSBE-në dhe gjithë donatorët e tjerë për përkrahjen dhe kontributin e tyre dhënë në fushën e ndërtimit dhe planifikimit hapësinor.

Ndërsa drejtori i Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim, Servet Spahiu, ka prezantuar detajet e këtyre udhëzimeve që, sipas tij, e plotësojnë infrastrukturën ligjore për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Ai ka treguar për

gjendjen e ndërtimeve pa leje që janë regjistruar në Regjistrin Nacional ku në total, sipas tij, janë mbi 350 mijë ndërtime pa leje. "Si informatë është një skemë që e kemi të ndërtimeve deri me ligjin e vjetër, ku janë 352 mijë 836 ndërtime pa leje në regjistrat që i kemi. Prej tyre janë 8 mijë e 461 që kanë aplikuar, ku vetëm 2 mijë certifikata të legalizimit janë lëshuar dhe shumica janë në Komunën e Prishtinës", ka thënë Spahiu. Udhëzimet Administrative që janë nënshkruar nga ministri Matoshi dhe që sot kanë hyrë në fuqi janë: Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen dhe kërkesat për Bazën e të

Dhënave të Legalizimit të ndërtimeve pa leje; Udhëzimi Administrativ për kërkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe II; Udhëzimi Administrativ për kërkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë III; Udhëzimi Administrativ për procedurat dhe kërkesat për rrënim të ndërtimeve pa leje dhe Udhëzimi Administrativ për procedurat e ankesave kundër vendimeve për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

## AKB-ja dhe DMPP-ja, me misionarë të përbashkët ekonomikë në shtatë shtete

PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) dhe Dhoma Kombëtare e Tregtisë kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Misionin Diplomatik për Paqe dhe Prosperitet (DMPP) me qëllim të ngritjes së përbashkët të kapaciteteve diplomatike dhe ekonomike në nivel kombëtar e më gjerë.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka deklaruar se niveli i ekonomisë vendore kombëtare po ngrihet por, sipas tij, ka nevojë për përfaqësim dhe promovim ekonomik dhe diplomatik. "Integrimi i vendit vjen atëherë kur ekonomia dhe investimet janë të qëndrueshme dhe permanente dhe jo sporadike siç i kemi sot. Në shumë vende ku nuk mund të depërtojë biznesi mund të ecim bashkë me ju me diplomaci dhe e vlerësoj si arritje të madhe këtë hap të përbashkët që ka munguar

deri sot", u shpreh Shahini.

Gubernuratori i DMPP-së, Shefki Hysa, ka thënë se i bashkojmë forcat me këto subjekte ekonomike në fushat e diplomacisë ekonomike e kulturore me qëllim të mbizotërimit të paqes globale, në veçanti të Ballkanit, me një traditë më konservative se ajo evropiane. "Misioni diplomatik ka prani në shumë vende të botës që ju mund t'i shfrytëzoni për të gjetur mundësi bashkëpunimi me biznesmenë të vendeve të ndryshme me qëllim të eksportit dhe importit të produkteve vendore që janë promotor i ekonomisë kombëtare", u shpreh Hysa.

Në fund palët pajtohen që deri në fund të vitit t'i emërojnë misionarët e përbashkët ekonomikë dhe diplomatikë në Gjermani, Austri, Slloveni, Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, Zvicër dhe Turqi.





## Korrje-shirjet në Drenas pritet të përfundojnë brenda dy javësh

DRENAS, 15 KORRIK (ER) - Me rastin e fillimit të fushatës së korrje-shirjes, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi, ka uruar hapjen e kësaj fushate në këtë komunë. Në njoftimin e kësaj komune është bërë me dije se me kohë janë bërë të gjitha përgatitjet e

duhura, ku fillimisht është formuar komisioni i cili do ta përcjellë fushatën e korrje-shirjeve. Fushata e korrje-shirjeve pothuajse ka filluar në të gjitha fshatrat e Komunës së Drenasit.

Në territorin e Drenasit janë të mbjella 1 762 hektarë me grurë,

ndërsa rendimentet këtë vit janë të kënaqshme dhe sillen mesatarisht rreth 3 000 - 3 500 kilogramë për hektar, ndërsa për elb 2 600 kilogramë për hektar. Nëse kushtet atmosferike janë të mira, fushata e korrje-shirjeve pritet të përfundojë brenda 14 ditësh.



## Pezullohet dhënia e lejeve të ndërtimit në Ferizaj



FERIZAJ, 15 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka mbledhur të hënën drejtorët e drejtorive komunale me të cilët ka diskutuar për një varg temash të qeverisjes lokale, përkatësisht në drejtoritë që ata drejtojnë. Drejtorët e drejtorive komunale e kanë njoftuar Aliun për ecurinë e punës në zbatim të platformës qeverisëse si dhe hapat që po ndërmerren në planin afatshkurtër për përmbushjen e objektivave të punës. Ata kanë bërë me dije se janë bërë gati për seancën e radhës të Kuvendit Komunal dhe për dëgjimet buxhetore për hartimin e Projektbuxhetit 2020-2022 të

cilat do të fillojnë sot (e martë). Ndër vendimet më të rëndësishme që ka marrë ekzekutivi i Ferizajt është ai për pezullimin e dhënies së lejeve të ndërtimit, saktësisht për objektet e banimit kolektiv, si masë efektive që do ta mundësojë mirëplanifikimin e territorit dhe ndërtimet sipas kriterëve dhe standardeve më të larta në këtë fushë. Kryetari Aliu ka thënë se për herë të parë pas 20 vjetëve, Komuna e Ferizajt po e merr këtë vendim të domosdoshëm për ta ndaluar keqplanifikimin e territorit dhe për t'i dhënë mundësi që me analizë paraprake të projektohen zonat dhe kushtet e ndërtimit.

## Komuna e Mitrovicës shënon përparim në inkasimin e të hyrave vetjake

MITROVICË, 15 KORRIK (ER) - Të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve e Komunës së Mitrovicës, ku janë diskutuar disa pika të rendit të ditës, që janë me interes për qytetarët e Komunës së Mitrovicës. Kjo mbledhje është drejtuar nga kryetari i komunës, Agim Bahtiri.

Drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka njoftuar ekzekutivin se përgjatë fundjavës inspektorët komunalë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë kryer kontrolle të shumta në lokalet e qytetit, zhurma e të cilëve është kthyer në burim shqetësues për qetësinë e qytetarëve. Ai më tutje theksoi se jo vetëm këtë fundjavë, por edhe në fundjavat në vijim, Drejtoria e Inspeksionit do t'i vijojë kontrollet në lokalet e qytetit me qëllim sigurimin e qetësisë publike për qytetarët.

Drejtori Ahmeti më tutje ka shtuar se Drejtoria e Inspeksionit edhe gjatë kësaj fundjave ka kryer kontrolle inspektuese për respektimin e orarit të punës nga subjektet afariste.

Ndërsa drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, ka theksuar se është shumë e rëndësishme që ansambli i këngëve dhe valle të qytetit të ketë një mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve të këtij ansambli. Me këtë rast, ekzekutivi ishte i pajtimit t'i ofrohet mbështetje ansamblit për krijimin e kushteve më të mira për punë, në mënyrë që ansambli të arrijë suksese.

Kurse drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka bërë me dije se nga 10 korriku Komuna e Mitrovicës ka filluar mbajtjen e dëgjimeve buxhetore për planifikimin e



buxhetit për vitet 2020-2022, dhe gjithsej do të mbahen shtatë dëgjime buxhetore.

Në fund të kësaj mbledhje drejtori Gashi ka theksuar se

Komuna e Mitrovicës ka shënuar përparim sa i përket inkasimit të të hyrave vetjake në dhjetë vjetët e fundit, ku në vitin 2010 komuna kishte realizuar inkasim të të

hyrave në vlerë 1,650,134.40 euro, ndërsa në vitin 2018 Komuna e Mitrovicës ka arritur të inkasojë të hyra vetjake në vlerë prej 2,280,284.67 eurosh.



## Muharremaj pret në takim përfaqësues të KFOR-it, diskutojnë për bashkëpunimin

SUHAREKË, 15 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, të hënën ka pritur në zyrën e vet komandantin e MNBG-W, të KFOR-it italian kolonel Daniele Pisani dhe përfaqësues të tjerë nga KFOR-i turk dhe austriak, së bashku me vartësit e tij italianë. Ata kanë bashkëbiseduar me


kryetarin Muharremaj lidhur me projektet që Komuna e Suharekës i ka realizuar deri më tani në mandatin e kryetarit Muharremaj si dhe për planet në vijim që kryetari Muharremaj ka. Ndërsa koloneli Daniele Pisani ka thënë se në Suharekë po ndihet shumë mirë. "Pashë një ambient të

pastër dhe të rregullt. Mendoj se jeni komuna shembull në Kosovë, andaj ju përgëzoj për këtë. Gjithashtu, kemi ardhur të njoftohemi me juve dhe t'ju informojmë për disa ndryshime që do të ndodhin në strukturën e KFOR-it, ndryshimet në komandë", ka thënë Pisani.



# Fizika simetrike, udhëtim drejt universit

Fizikani Naim Krasniqi paralajmëron shembjen e themeleve të fizikës, duke përfshirë fushën e astronomisë, strukturën e brendshme të atomit, optikën, akustikën dhe shumë fusha të tjera që kanë një lidhshmëri me fenomene të njëjta. Kërkon një modifikim ekstrem të lëndës së fizikës dhe formimin e një dege të veçantë të fizikës e cila do të quhej fizika simetrike. Krasniqi, gjithashtu, hedh poshtë idetë e NASA-s, ESA-s mbi kolonizimin e Marsit



**Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan**

Pa pranimin e këtij realiteti asnjë agjenci hulumtuese, duke përfshirë edhe agjencinë NASA, ESA, CNES nuk mund ta kuptojnë as ta zgjidhin misterin e jetës në tokë as në univers. Sado injorant ekstrem që kanë qenë ndaj meje dhe kërkesave të mia, këto shënime për ta dhe për të gjithë të tjerët janë një kushtetutë shkencore që duhet respektuar, prandaj këto agjenci që shpenzojnë miliarda dollarë për ta njohur universin, përmes teleskopëve nuk u duhen më shumë se 500 dollarë për të kryer të njëjtat eksperimente që i kam kryer unë.

Ta lexosh, nuk do të thotë se do ta kuptosh, dikush do ta kuptojë mos tani, më vonë, por shumëkush asnjëherë? E falënderoj stafin e gazetës "Epoka e re", por edhe të gjitha ato mjete të informimit që i marrin shënimet nga kjo gazetë dhe i botojnë.

E kuptoj fare mirë që një gazetë ditore të publikojë shkrime shkencore në një tirazh kaq të gjatë nuk është aspak normale, por kjo nuk është rruga që e kam zgjedhur, por e vetmja rrugë që më ka mbetur, në mënyrë që opinioni të sensibilizohet dhe të paktën ta kuptojë esencën e këtyre shkrimeve. Kam provuar gjatë dhe në çdo mënyrë që të kontaktoj dhe të marr takime me institucione dhe njerëz kompetentë të kësaj fushe që t'i prezantoj këto ide të bazuara në argumente eksperimentale, por të gjitha kanë qenë të kota.

Këto kërkesa i kam bërë në institucione të ndryshme përmes postës së sigurt, me emra e mbiemra që argumentohen edhe përmes pranimit, duke përfshirë edhe agjencitë NASA (National Aeronautic ESA (The European Space Agency) CNES (Centre National de Etudes Spatiales) dhe shumë e shumë të tjera.

Kam kontaktuar personelin që punon në INPI (Institut Nationale

de la Propriete Industrielle) të cilët kanë tentuar që të më bëjnë takime me njerëz dhe institucione kompetente, por pa asnjë rezultat. E gjithë kjo bllokadë, sipas informatave që kam, ka një argument, jam duke prekur tema shumë të ndjeshme në shkencë dhe askush nuk merr guxim ta pranojë një realitet të tillë, sepse pranimi i këtij realiteti do ta shkatërronte pjesën më të madhe të bazave të fizikës së tanishme, jo vetëm në fushën e astronomisë, por edhe strukturën e brendshme të atomit dhe shumë fusha të tjera.

Por, sipas mendimit tim personal, pengesë e takimeve mund të jenë emri, mbiemri dhe nacionaliteti, sepse pjesa më e madhe nuk janë të gatshëm ta pranojnë që një kosovar t'i përmbysë teoritë e institucioneve të tyre më bashkëkohore.

Madje këto teori do të zhvlerësonin edhe punën e agjencive të hulumtimit të hapësirës, qoftë të NASA-s, ESA-s, të cilët kohë pas kohe japin informata të frikshme dhe të pavërteta mbi rrezikimin e tokës nga goditjet e trupave të tjerë qiellorë, goditjet e erërave diellore, dërgimin e njerëzve në planetin e Marsit, por duke mos sqaruar dhe duke mos ditur aspak realitetin kush na sulmon, në cilën kohë na sulmon, pse na sulmon, kush na mbron dhe si na mbron?

Kur sulmohemi, si sulmohemi dhe kush është faktori kryesor që na mbron neve në tokë dhe e mbanë stabil universin nga shkatërrimi, është një forcë që nuk ka të bëjë aspak me një energji të zezë ashtu siç e quan shkenca e sotme, një energji që nuk vjen, nuk ka emër as burim.

Kjo forcë që e mban stabil universin, ka një emër dhe një burim. Prandaj, duke filluar nga fenomenet që ndodhin në natyrë duke kryer eksperimente nga më të thjeshtat deri tek ato më të ndërlikuarat, do të bindemi mbi praninë e kësaj force të pazbuluar deri më tani.

Për ta kuptuar më thjesht dhe më mirë praninë e kësaj force duhet kërkuar burimin e kësaj force, prandaj këtë forcë do të fillojmë ta kërkojmë nga disa fenomene që ndodhin në natyrë sot siç janë ciklonet dhe tornadot.




Fig 1




Fig 2




Fig3




Fig 4

## Ciklonet dhe tornadot si dy fenomene natyrore

Ciklonet janë stuhi në të cilat erërat rrotullohen rreth qendrës me shpejtësi të ndryshme. Diametri mesatar i tyre sillet prej 500 dhe 1000 kilometrash. Lartësia e tyre mesatare nga sipërfaqja është rreth 15 kilometra. Kurse, tornadot ndryshojnë nga ciklonet, sepse janë stuhi të dhunshme që ndryshojnë për nga forma dhe madhësia me ciklonet, si për nga diametri mesatar i tyre, që është rreth 100 metra, po ashtu, edhe për nga lartësia që shkon rreth 200 metra.

## Forma e krijimit të ciklonëve dhe tornadove

Edhe pse këto fenomene natyrore mendohet se shkaktohen gjatë ndryshimit të temperaturave, një gjë e tillë nuk është vërtetuar asnjëherë në laboratore të mbyllura që në ndonjë formë eksperimentale të ngacmohet një proces i tillë nga i cili do të buronte ndonjë stuhi sado e vogël, që do të rrotullohej rreth qendrës. Prandaj, sido që të jetë, ciklonet dhe tornadot janë fenomene natyrore që e kanë një origjinë, një burim dhe një forcë që e shkakton atë fenomen.

Por nëse bëhen analiza të detajuara, arrijmë në përfundim se këto fenomene natyrore krijohen gjatë proceseve kimike, përkatësisht gjatë bashkëveprimit të atomeve të elementeve të ndryshme.

Në bazë të asaj se çfarë shihet e çka ndodh, këto fenomene shkaktohen gjatë një kontakti të drejtpërdrejtë të atomeve të tri elementeve (aX) (aY) (aZ) që e shkaktojnë fenomenin e tornadove dhe cikloneve, kurse prania e elementit të katërt janë atomet (a?) që e paralizojnë apo shpërndajnë masën e atomeve të lartcekura. Ngjashëm sikur ciklonet edhe tornadot krijohen gjatë bashkëveprimit të atomeve të tri

elementeve (aX) (aY) (aZ).

Gjatë këtij procesi formohet një bërthamë, nga e cila burojnë valë që rrotullohen rreth bërthamës, të cilat valë gjatë rrotullimit formojnë erëra të fuqishme ku shpejtësia e tyre varet nga madhësia e bërthamës.

Bazuar në dy rastet e lartpërmendura ku gjatë bashkëveprimit të atomeve të elementeve (aX) dhe (aY) formohen ciklonet, kurse për ndryshim nga ciklonet, tornadot formohen gjatë bashkëveprimit të atomeve të elementeve të (aX) dhe (aZ), çka do të thotë se sikur ciklonet ashtu edhe tornadot kanë një element të përbashkët (aX). Kurse prania e elementit (a?) gjatë këtij reaksioni e paralizon apo e shpërndan elementin (aX) me çka bëhet shuarja e cikloneve dhe tornadove. Nga bërthamat e cikloneve dhe tornadove burojnë valë që shpërndahen në dy drejtime. Valët që shpërndahen dhe rrotullohen rreth qendrës në drejtim të boshtit (x) formohen gjatë bashkëveprimit të atomeve të elementeve (aX) dhe (aY), prandaj boshti (x) paraqet gjerësinë përkatësisht diametrin e cikloneve, kurse boshti (y) paraqet lartësinë e cikloneve (shih figurën 1). Kurse valët që shpërndahen dhe rrotullohen rreth qendrës në drejtim të boshtit (y) formohen gjatë bashkëveprimit të atomeve të elementeve (aX) dhe (aZ), prandaj boshti (y) paraqet lartësinë e tornadove, kurse boshti (x) paraqet gjerësinë e tornados (shih figurën 2).

## Formimi i planetit të tokës

Para krijimit të tokës i gjithë universi ishte i mbushur me atome të elementeve të ndryshme qoftë në gjendje të lëngët, të ngurtë apo të gaztë. Duke mos u ndalur në reaksionet e tjera të elementeve që ndodheshin në univers, ne do t'i cekim vetëm reaksionet që ndodhin gjatë bashkëveprimit të katër

elementeve (X.Y.Z.?) të cilat gjendeshin në gjendje të lirë në univers, kurse atomet e të këtyre elementeve do t'i shënojmë (aX) (aY) (aZ) (a?).

Përreth hapësirës ku ka filluar krijimi i planetit tonë, gjatë bashkëveprimit të atomeve të dy elementeve (aX) dhe (aY) është formuar bërthama e ciklonit të tokës.

Valët që burojnë nga bërthama e këtij cikloni shpërndahen në drejtim të boshtit (x), në formë të një disku me diametër me qindra mijëra kilometra nga qendra, dhe me mijëra kilometra lartësi.

Ky disk i ciklonit të tokës nuk është asgjë tjetër veçse një disk krijues i planetit të tokës.

Cikloni apo disku krijues i planetit të Tokës rreth vetes ka filluar në të njëjtën kohë t'i tërheqë dhe t'i rrotullojë rreth bërthamës të gjitha elementet, pa marrë parasysh gjendjen e tyre të lëngët, të gaztë apo të ngurtë.

Së pari i ka tërhequr elementet e rënda rreth bërthamës në të cilat hyjnë materialet feromagnetike siç janë hekuri, nikeli dhe kobalti.

Në këtë mënyrë rreth bërthamës së ciklonit është formuar një sferë që përbëhet nga materialet feromagnetike, në veçanti hekuri dhe nikeli me një rreze prej 3846 km.

Përpos materialeve feromagnetike, bërthama e ciklonit ka tërhequr edhe elemente të tjera më të lehta duke formuar shtresa të tjera rreth sferës feromagnetike (shih figurën 3).

Por, ndryshe nga hapësira ku është krijuar cikloni, krijues i tokës në distanca dhe kohë të njëjta apo të ndryshme janë formuar edhe bërthama të tjera të tornadove dhe cikloneve.

Më afër bërthamës së ciklonit të tokës gjatë një reaksioni në mes atomeve të elementeve (aX) dhe (aZ) është formuar një fenomen tjetër që do ta quajmë bërthama e tornados elektromagnetike (shih figurën 4). **Vijon.**



## May i dënon deklaratat e Trumpit kundër kongresisteve

LONDËR, 15 KORRIK - Kryeministrja në largim e Britanisë së Madhe, Theresa May, e kritikoi presidentin e Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, pasi ky i fundit iu bëri thirrje disa kongresisteve demokrate me ngjyrë që "të kthehen në shtëpitë e tyre". May tha se fjalët e Trumpit janë "krejtësisht të papranueshme", transmetoi zëdhënësi i saj.

Trumpi tha përmes disa postimeve në "Twitter" se gratë "kanë ardhur nga vendet, qeveritë e të cilave janë një katastrofë totale". Ai iu referua katër kongresisteve - tri nga të cilat kanë lindur në ShBA, ndërsa një ka shkuar si fëmijë refugjat. Kandidatët demokratë për president i cilësuan deklaratat e tij si raciste dhe përçarëse, ndërsa

përfaqësuesit e Partisë Republikane qëndruan të heshtur. Gratë Aleksandria Ocasio-Cortez, Rashida Tlaib, Ayanna Pressley dhe Ilhan Omar e quajtën presidentin racist dhe u mbështetën nga anëtarë të Partisë Demokratike. Përkundër kritikave, Trumpi të hënën iu bëri thirrje vetë grave që të kërkonin falje.



# Trumpi u turrent kongresisteve: Shkoni nga keni ardhur, rregullojini shtetet e juaja

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, i tha një grupi të ligjvënësve demokrate me ngjyrë, kryesisht të lindura në Amerikë, të kthehen dhe të ndihmojnë në rregullimin e vendeve të kriminit dhe krejtësisht të shkatërruara nga të cilat kanë ardhur

UASHINGTON, 15 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i tha një grupi të ligjvënësve demokrate, kryesisht të lindura në Amerikë, të "kthehen dhe të ndihmojnë në rregullimin e vendeve të kriminit dhe krejtësisht të shkatërruara nga të cilat kanë ardhur".

Komentet e presidentit Trump u cilësuan nga demokratët si "raciste", pasi bëhet fjalë për ligjvënësve me ngjyrë. "Shumë interesante t'i shohësh kongresistet 'përparimtare' demokrate të cilat me origjinë vijnë nga vendet, qeveritë e të cilave janë katastrofë e plotë, duke u thënë njerëzve në ShBA si duhet të udhëhiqet qeveria jonë", tha Trumpi.

Derisa nuk përmendi emrat, Trumpi duket se iu referohej kongresisteve Alexandria Ocasio-Cortez të Nju Jorkut, Ilhan Omar nga Minesota, Ayanna Pressley nga Massachusetts dhe Rashida Tlaib nga Michigan - një grup i

njohur si "skuadra" që ka qenë shumë kritike ndaj Trumpit dhe, gjithashtu, udhëheqes demokrate të Kongresit.

Vetëm Omar, familja e së cilës u largua nga Somalia si refugjate dhe mbërriti në Minneapolis në vitin 1997, ka lindur jashtë Shteteve të Bashkuara. "Zoti president, vendi prej të cilit kam ardhur dhe vendi me të cilin ne të gjithë betohemi, është Shtetet e Bashkuara. Ju jeni të zemëruar për shkak se ju nuk mund të mendoni për një Amerikë që na përfshinë edhe neve", shkroi kongresistja Ocasio-Cortez.

Deklaratat e presidentit Trump ngjallën reagime në mesin e demokratëve.

Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, i quajti komentet e tij "ksenofobike". "Kur Trumpi u thotë katër kongresisteve amerikane të kthehen në vendet e tyre, ai riafirmon se plani i tij për të bërë Amerikën e madhe përsëri ka qenë gjithmonë për ta bërë Amerikën të



bardhë përsëri", tha ajo në Twitter.

Një javë më parë Pelosi kishte një përplasje me katër kongresistet lidhur me çështjet e migracionit por, megjithatë, ajo u doli në mbrojtje pas deklaratave të Trumpit.

Udhëheqësi i shumicës së Senatit, republikani Mitch McConnell, nuk iu përgjigj kërkesave për t'i komentuar deklaratat e Trumpit. Por, presidenti Donald Trump nuk po kërkon falje për

deklaratat ndaj katër kongresisteve. Përmes një postimi në "Twitter", të hënën presidenti amerikan tha se "ato duhet të kërkojnë falje për deklaratat që kanë bërë ndaj tij dhe Izraelit". Në vitin 2018 presidenti Trump i tha një gazetari: "Unë nuk jam racist. Unë jam personi më pak racist që keni intervistuar ndonjëherë".

Por, shumë nuk pajtohen me këtë deklaratë dhe presidenti është akuzuar për racizëm shumë herë

në lidhje me incidente të ndryshme.

Trumpi me vite ka bërë pretendime se ish-presidenti Barack Obama nuk ka lindur në ShBA. Ai gjithashtu ka bërë shumë deklarata kundër migrantëve të Amerikës Qendrore, duke i quajtur kriminelë dhe përdhunues.

Në vitin 2018 ai u përball me kritika nga demokratët dhe republikanët, pasi u raportua se gjatë një takimi në Shtëpinë e Bardhë ai i ofendoi kombet afrikane.

## Evropianët bëjnë thirrje për dialog mes Iranit dhe ShBA-së

TEHERAN, 15 KORRIK - Presidenti iranian Hassan Rouhani tha se vendi i tij është gati të negociojë me Shtetet e Bashkuara nëse Uashingtoni iu jep fund sanksioneve ekonomike. Ndërkohë, krerët evropianë bënë thirrje për bisedime, për t'i dhënë fund eskalimit në rritje midis Teheranit dhe Uashingtonit. Shtetet e Bashkuara vitin e kaluar u tërhoqën nga një marrëveshje bërthamore me Iranin dhe vendosën sanksione pasi adminis-

trata Trump tha se marrëveshja do t'i mundësojë Teheranit që të prodhojë një armë bërthamore për disa vjet.

Sanksionet kanë shkatërruar ekonominë iraniane. Në përgjigje, Teherani ka ndërmarë hapa për ta pasuruar uraniumin përtej kufijve të imponuar nga kjo marrëveshje, duke shkaktuar më shumë kërcënime ndaj sanksioneve nga Shtetet e Bashkuara.

Britania, Franca dhe Gjermania kanë mbetur pjesë e marrëvesh-

jes bërthamore, ashtu si Rusia dhe Kina.

Britania, Franca dhe Gjermania më 14 korrik u bënë thirrje "të gjitha palëve të përfshira, ta ndalojnë përshkallëzimin dhe t'i marrin në konsideratë pasojat e mundshme të veprimeve të tyre". "Ne besojmë se ka ardhur koha për të vepruar me përgjegjësi dhe për të kërkuar një rrugë për ta ndaluar përshkallëzimin e tensioneve dhe për ta rifilluar dialogun", thuhet në deklaratë.







# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



*Shijo  
Pranverën  
me...*





**E jashtëzakonshme**

# Pesë ditë mbi WC për ta thyer rekordin

Një belg qëndroi i ulur në WC për gati pesë ditë në përpjekje për të vendosur një rekord botëror. Jimmy De Frenne sfidoi veten për të qëndruar ulur për 165 orë në WC në mes të një lokali. Por hoqi dorë javën e kaluar pas 116 orësh qëndrimi ulur. Nuk ka



një rekord botëror për qëndrimin ulur në WC, por De Frenne ka thënë se kishte njohur dikë që qëndroi ulur për 100 orë.

**FOTO E DITES**



Bishti i një balenë në ujërat e Oqeanit Paqësor në Ishullin Contadora në Panama. /AFP/

**E rrallë**

# Superjahti luksoz del në shitje, kontrollohet me iPad

Një superjaht luksoz është nxjerrë në shitje për 15 milionë dollarë. "Adastra" fitoi një seri çmimesh për dizajnin e saj në 2013 dhe mund të kontrollohet me iPad. Jahti është në pronësi të miliarderit Anto Marden. Dizajni "futuristik" duket si i dalë nga një film i zhanrit 'Sci-Fi', me



krahë aerodinamikë që e ndihmojnë të lundrojë. Jahti ka 43 metra dhe është projektuar për t'i ngelur çdokujt në mendje. Vetëm 20 për qind e tij zhytet në ujë dhe konsumon rreth 14 për qind të sasisë së karburantit.

## BARSOLETA E DITËS



Fadili në një çajtoze nuk ndalet së piri çaj. Kamerieri, i mërziur me porosinë e tij, lodhet dhe i thotë:

- O Fadil, i 17-ti.

Fadili:

- Po bre, shkoi dhe ky muaj. Qitma edhe një çaj.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)**  
**"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min  
**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan  
**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val



**Ne ora 18:00**

### "X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain  
**Regjia:** Simon Kinberg



**Në ora 20:00**

### "MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson  
**Regjia:** F. Gary Gray




**Ne ora 22:00**

### "M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown  
**Regjia:** Tate Taylor



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Mos u frikësoni nga persona që mendojnë gjithmonë si t'ju vënë në vështirësi. Bëni mirë të mos i konsideroni fare kushdo që të jetë arsyeja.</p>	 <p><b>DEMI</b> Mos merrni përsipër gjëra të reja apo iniciativa financiare nëse nuk jeni të sigurt që keni mbyllur punët dhe projektet e nisura më parë.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Është një çast i përshtatshëm për investime dhe nëse bëni një hap tani do të përfitoni shumë në të ardhmen tuaj.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Ditë mjaft entuziaste dhe me mjaft optimizëm. Ndhieni të gjallë dhe të gatshëm të merrni përsipër projekte të reja.</p>	 <p><b>LUANI</b> Do të gjendeni duke zgjidhur keqkuptimet midis miqve ose kolegëve që nuk i keni shkaktuar ju, por kudo nevojitet një amortizator për t'i ulur tonet.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Emocione të bukura për këdo nga ju që ka nisur një punë të re ose është zhvendosur në një vend të ri. E panjohura po ju tërheq.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Sot nëse bini pre e provokimeve do të keni mjaft debate që nuk do t'ju çojnë askund. Mbase po të tregoheni më të matur do t'ia dilni të mos përfshihen.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Po tërhiqni pas vetes një problem prej kohësh dhe nuk po arrini dot ta zgjidhni. Kërkoni mendime diku ku keni besim se mund t'ju ndihmojnë.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot fati është në anën tuaj. Diçka që e ëndëroni prej kohësh sot do të bëhet realitet dhe ju do të ndiheni mjaft të realizuar.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Kujdes me shpenzimet sot sepse duhet të reduktoheni të merrni vetëm gjëra të nevojshme. Tregohuni më të matur në financa.</p>	 <p><b>UJORI</b> Tregohuni shumë të kujdesshëm me letrat sot. Lexoni shumë mirë gjithçka që do t'ju duhet të firmosni sepse mund të keni pasoja.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Nëse përgjatë një kohe të caktuar keni qenë në krizë, sot do të ndryshojë gjithçka. Do të vëreni përmirësime në të gjitha fushat e jetës.</p>



## Nicole Scherzingeri tregon se mosha nuk njih kufi

**K**ëngëtarja e njohur Nicole Scherzinger mori vëmendjen e medieve përsëri me lajmin se ajo do të rikthehet në 'X Factor'. Atë e fotografuan paparacët gjatë fundjavës teksa ishte në rrugët Beverly Hills. Nicole duket se ishte në formë, pasi dukej shumë seksi në rrobat që pati të veshura. Bluza e kuqe për trupi dhe pantallonat e zi i vinin në pah linjat e saj trupore përkundër moshës 41-vjeçare.



## Rita Ora xhiron videoklipin e ri në Dubai

**K**ëngëtarja e njohur me prejardhje nga Prishtina, Rita Ora, ka publikuar një pjesë të videoklipit të këngës "New Look" të cilin e ka xhiruar në Dubai të Emirateve të Bashkuara

Arabe. Ora këtë lajm e ka bërë me dije me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram". "Në Dubai kishte shumë argëtim me vetura të mrekullueshme", ka shkruar Ora.


## Beyonce merr vëmendjen e të gjithëve në premierën e "Lion King"



**K**ëngëtarja e njohur Beyonce ka marrë vëmendjen e të gjithëve në premierën evropiane të filmit "Lion King" të mbajtur në kinemanë Odeon Luxe në Leicester Square. Beyonce është zëri dublues i Nala në këtë film, pos kësaj ajo këndon edhe

kolonën zanore të filmit "Spirit". Ajo ka nxjerrë në pah luaneshën e saj të brendshme me anë të fustanit ngjyrë ari që veshi gjatë kësaj premiere të filmit. Këngëtarja ishte e shoqëruar nga burri i saj, Jay Z. Ata të dy dukeshin të lumtur me njëri-tjetrin.

## Martohet këngëtari Chuck Wicks



**K**ëngëtari Chuck Wicks është martuar me Kasi Williams, e cila është motra e yllit të muzikës country Jason Aldean. Këtë martesë për "People" e ka konfirmuar vetë Wick. Ai ka thënë se

bashkë me gruan ndihen sikur kjo të ishte një ëndërr për ta. "Çdo moment ishte befasues, por pjesa më e mirë e jona ishte se ishin me familjet dhe miqtë tanë të afërt", ka deklaruar Wick.



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN  
 SEKURIT PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

**QENDRA SPORTIVE**

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Feronikeli, gati ta shkruajë historinë në Ligën e Kampionëve

Kualifikimi në rrethin e dytë të Ligës së Kampionëve është synim i skuadrës më të mirë në Kosovë, Feronikelit. Skuadra nga Drenasi ka nxjerrë barazim në ndeshjen e parë që është zhvilluar në Uells (2-2) dhe tash konsiderohet favorit për ndeshjen kthyesë, e cila fillon nga ora 20:45 dhe zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri"



**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - KF Feronikeli është gati ta mposhtë The New Saints në ndeshjen kthyesë në Ligën e Kampionëve dhe ta shkruajë historinë sonte (e martë) në stadiumin "Fadil Vokrri". Ndeshja kthyesë e rrethit të parë fillon në orën 20:45. Lojtari më i mirë i "Nikli" në ndeshjen e parë në Uellsit, Astrit Fazliu, ka thënë për "Epokën e re" se të gjithë futbollistët e Feronikelit do ta japin maksimumin për t'u kualifikuar në rrethin e dytë dhe në këtë mënyrë ta shkruajë historinë si skuadra e Kosovës që ka arritur më së larti në garën e Ligës së Kampionëve. "Ne do ta japim maksimumin që ta kalojmë skuadrën e TNS-së, pasi këtu nuk po luajmë vetëm për klubin tonë, por për futbollin e Kosovës në përgjithësi. Kemi pasur paraqitje të mirë, sidomos në fund të ndeshjes. Shpresoj se edhe

në të martën të luajmë ashtu dhe të kualifikohemi", ka thënë Fazliu. "Është një ndeshje shumë e rëndësishme, prandaj presim të kemi përkrahje të madhe dhe ndeshjen ta rikthejmë në spektakël sportiv, pasi kualifikimi ynë në rrethin e dytë është historik për Feronikelin dhe Kosovën", ka shtuar sulmuesi i Ferizajt, Prishtinës dhe Dritës. Optimist për kualifikimin në rrethin tjetër është edhe futbollisti i TNS-së, Paul Harrison. "Ne do të luajmë me moralin lart, edhe pse kemi pësuar dy gola. Ne duhet të shkojmë me besim dhe ta japim më të mirën tonë", ka thënë Paul Harrison për "BBC". Duke parë rëndësinë e madhe të ndeshjes, kryetari i skuadrës nga Drenasi, Naser Ramaj, ka vendosur t'i dhurojë 3 000 bileta falas për të gjithë ata që duan të jenë në stadiumin "Fadil Vokrri". Këto bileta shpërndahen sot (e martë) nga ora 09:00 - 12:00 në pikat shitëse të lartcekura dhe do të jepet vetëm një

biletë për person. Kjo nuk është e tëra pasi kryetari Ramaj ka vendosur që të gjithë edhe të gjithë invalidët e luftës duke i mundësuar hyrjen në stadium pa pagesë. Ndeshjen në mes të kampionës së Kosovës, Feronikelit dhe skuadrës nga Uellsit, The New Saints, e ka komentuar edhe analisti i futbollit në Kosovë, Genc Sermaxhaj. Ai ka thënë se duke e pasur parasysh rezultatit e ndeshjes së parë 2-2, "Nikli" është favorit për t'u kualifikuar në rrethin tjetër të garës më të madhe në futboll. "Rezultati i ndeshjes së kaluar është përparësi për skuadrën tonë dhe na konvenojnë edhe dy rezultate të barabarta (0-0, 1-1), por duke e pasur parasysh se jemi mirë në aspektin psikik, pres të kalojmë pozitivisht. Besoj se Feronikeli e kalon këtë raund dhe do të bëhet ekipi i parë nga Kosova që ka kaluar më së shumti rraunde në parakualifikimet e Ligës së Kampionëve", ka deklaruar Sermaxhaj.

## SHKURT

### Maloku, krenar që bëhet pjesë e Prishtinës

FC Prishtina ka arritur marrëveshje me talentin gjakovar Art Maloku. Qendërmbrojtësi ka zhvilluar të gjitha ndeshjet e stinorit pranveror me Vëllaznimin, kurse ka qenë pjesë e grupmoshave të reja të përfaqësueses së Kosovës. "Normalisht, kam qenë i befasuar dhe i mrekulluar me interesimin e Prishtinës. Pa dyshim se pranova ofertën që të jem pjesë e klubit më të madh në vend. Shpresoj dhe besoj shumë të imponohem dhe t'i tregoj aftësitë e mia. Falënderoj shumë familjen, posaçërisht babanë që më ka mbështetur. Shpresoj shumë se do të realizoj ëndrrën", ka thënë Maloku.

### Drita transferon Bunjamin Shabanin

Skuadra e Dritës nga Gjilani është përforcuar me anësin Bunjamin Shabanin. Futbollisti nga Kumanova më parë ka qenë pjesë e skuadrave si: Bashkimi, Milano Kumanovë, Shkupi, Shkëndija, Partizani. Ndërsa së fundi ishte pjesë e skuadrës armene Shirak Gyumri.

### Ramsey, i lumtur që është pjesë e Joves

Mesfushori nga Uellsit, Aaron Ramsey, është prezantuar në skuadrën e Juventusit. Ai ka thënë se është shumë i lumtur se do të jetë pjesë e "Zonjës së Vjetër". "Jam shumë i lumtur që ndodhem te Juventusit. Po punoj fort për t'u bashkuar me ekipin sa më shpejt. Rikuperimi po shkon mirë dhe po kthehem në formë. Kur dëgjova për interesimin e Joves, mendova se do të ishte një ëndërr, përveçse një sfidë e madhe", ka thënë Ramsey.

### Bayerni kërkon talentin Leon Dajaku

Leon Dajaku është shumë afër që të transferohet te Bayern Muncheni në këtë afat kalimtar. Futbollisti shqiptar që aktualisht luan te Stuttgart është duke u kërkuar me ngulm nga kampioni i Bundesligës, e që marrëveshja është shumë afër të arrihet. Sipas gazetës gjermane "Kicker", Dajaku thuhet se nuk dëshiron ta humbet shansin që të kalojë në "Allianz Arena", derisa është pajtuar për kushtet personale me Bayernin. Dajaku mund të ushtrojë me ekipin e dytë të Bayernit, i cili luan në ligën e tretë gjermane.

### Osmani beson se Shkëndija mund të kualifikohet

Trajneri Qatip Osmani para ndeshjes së kthimit me Nomme Kalju në raundin e parë kualifikues të Ligës së Kampionëve, beson në kualifikimin e Shkëndijës, por është i vetëdijshëm se kuqezinjët duhet të kenë kujdes dhe të eliminojnë gabimet që bënë në takimin e parë, përtej rezultatit pozitiv të arritur, 1-0. "Pas ndeshjes së parë, brenda javës kemi analizuar gabimet që i bëmë në takimin e luajtur në Talin, ndërsa tash presim që të marrim kualifikimin për në raundin tjetër", ka deklaruar Osmani.



## Grumbullohen 'dardanët'

PRISHTINË, 15 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll të hënën paradite kishte grumbullimin e parë, derisa stërvitjet i zhvilloi edhe pasdite nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. "Dardanët" përgatitjet do t'i zhvillojnë dy herë në ditë, kurse gjatë fundjavës do të kenë

dy ndeshje miqësore në udhëtim me Sllovakinë. Stërvitja e parë ka qenë më shumë fizike, kurse me kalimin e ditëve do të shtohet edhe intensiteti. I vetmi që mungoi ishte Arian Qallaku për arsye dëmtimi, kurse Dardan Kapiti, Atik Koshi dhe Meriton Ismaili ndodhen me Kosovën U-20 në

Kampionatin Evropian, Divizioni B, që po zhvillohet në Portugali. Kosova ndodhet në grup me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe, ku fituesi i grupit kualifikohet tutje. Parakualifikimet për "Eurobasket 2021" do të zhvillohen nga 3 deri më 17 gusht.



# 'Dardanët' sot debutojnë në Botëror

Kosova U21 në hendboll është e gatshme që të debutojë në Kampionatin Botëror. Ndeshja e parë e "Dardanëve" të rinj është nga ora 17:00 ndaj Kroacisë. "Në Botëror, natyrisht se na presin ndeshje të vështira. Djemtë janë të vetëdijshëm që po shkruajnë kapitull të ri në historinë e sportit të Kosovës dhe jemi të përkushtuar ta bëjmë më të mirën e mundshme", ka thënë Fatmir Muhaxheri, përzgjedhës i Kosovës

### "Epoka e re"

PRISHTINË, 15 KORRIK - Përfaqësuesja U21 e Kosovës në hendboll të hënën në mesditë ka arritur në Spanjë, ku do të garojë në Kampionatin Botëror të juniorëve. Delegacioni i udhëhequr nga presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës (FHK), Eugen Saraçini. Kosova zhvilloi stërvitjen e parë në Spanjë, ndërsa sot (martë) do ta bëjë debutimin ndaj një kundërshtarëve të fortë siç është Kroacia. Me kualifikim në Botëror, U21-shat e Kosovës në hendboll tashmë kanë bërë histori, pasi është hera e parë që një përfaqësues e Kosovës garon në botëror, ngjarjen më të madhe. Djemtë "dardanë" kanë synime edhe për Botërorin që prej të martës mbahet në Spanjë, ndonëse janë të vetëdijshëm se kundërshtarët janë shumë të fortë. Në Botëror nuk mund të shpresohet për kundërshtar të dobët, por Kosova është përgatitur për të bërë befasi. Në kuadër të grupit C, të martën nga ora 17:00 luhet ndeshja Kroacia - Kosova. Ndeshja luhet



në Pontevedra të Spanjës, që së bashku me Vigon janë qytete nikoqire të Botërorit të 22-të të juniorëve. Kroacia e ka hendbollin shumë të zhvilluar. Kështu në Botërorin e Juniorëve, Kroacia ka synime për medalje. Gjenerata aktuale e juniorëve të Kroacisë ka suksese të shumta si: medalja e argjendtë në Kampionatin Evropian për të Rinj, vendi i katërt në Kampionatin Botëror për të Rinj dhe vendi i gjashtë në Kampionatin Evropian për Juniorë. Trajneri i Kosovës, Fatmir

Muhaxheri, është optimist për paraqitje dinjitoze në një ngjarje kaq të madhe në sportin e hendbollit. "Kemi bërë punë shumë të mirë gjatë përgatitjeve. Jemi të kënaqur me përkushtimin e lojtarëve dhe punën që është bërë me ta. Kemi qenë të angazhuar plot pesë trajnerë. Në Botëror natyrisht se na presin ndeshje të vështira. Djemtë janë të vetëdijshëm që po shkruajnë kapitull të ri në historinë e sportit të Kosovës dhe jemi të përkushtuar që ta bëjmë më të mirën e mundshme", ka thënë Muhaxheri.

# Vetteli heq dorë nga titulli

BERLIN, 15 KORRIK - Një tjetër garë për t'u harruar kjo e Sebastian Vettelit, që në pistën e Silverstones u rendit në vendin e 16 pas aksidentit me Max Verstappen dhe penalizimit që mori nga komisarët e pistës. Piloti i Red Bullit parakaloi Vettelin, që në përpjekje për ta rimarrë pozicionin gaboi, frenoi me vonesë dhe përfundoi në pjesën e pasme të makinës së holandezit. "Ishte një gabim imi. Mendova se kisha hapësirën e duhur për ta parakaluar, por ishte vonë. Nuk mund ta evitoja aksidentin. Megjithatë, deri në atë çast gara po shkonte mirë. Bëra një gabim dhe e pësova, pasi nuk pata me kohë për ta korrigjuar gabimin", u shpreh Sebastian Vettel. "Makina ishte e shpejtë dhe isha i kënaqur me ritmin që Ferrari kishte në garë.



Megjithatë, tashmë Hamiltoni është shkëputur shumë, ndaj botërori mund të konsiderohet i mbyllur. Gabimet, herë të

Ferrari e herë të pilotëve, na penalizuan këtë sezon deri më tani", tha Vetteli, që është 100 pikë pas Hamiltonit në renditje.

### SHKURT

#### Casillasi tërhiqet nga futbolli

Iker Casillasi është tërhequr përfundimisht nga futbolli i luajtur, por jo nga futbolli. Ish-portieri i Real Madridit dhe Spanjës para dy muajsh pësoi një sulm të zemër, i cili i rrezikoi seriozisht jetën dhe e detyroi atë të heqë dorë nga futbolli i luajtur. Spanjolli do të vazhdojë të jetë pjesë e Portos jo si lojtar, por si pjesë e stafit. "Do të bëj diçka ndryshe nga ajo që kam bërë në fushë. Do të përpiqem të jem lidhja në mes të ekipit dhe klubit. Misteri më tha se donte që të qëndroja me ekipin, pranë lojtarëve, pranë futbollistëve më të rinj, sepse do të ketë shumë ndryshime. Do të përpiqem të bëj më të mirën për shokët e mi", ka thënë Casillasi.

#### Roma e josh Higuainin me shiritin e kapitenit

AS Roma vazhdon të mos heqë dorë nga transferimi i Gonzalo Higuait. Sulmuesi argjentinas është pjesë e Juventusit deri në vitin 2021. Qëndrimi te bardhezinjtë do të thotë qëndrim në stol dhe Roma po tenton të përfitojë nga kjo situatë. "Verdhekuqtë" kërkojnë ta marrin "Pipitën" në formë huazimi me të drejtë blerje por, me një kusht: ai duhet ta ulë rrogën nga 6.5 në 4.5 milionë euro në sezon. Juventus është gati ta thjeshtësojë largimin e sulmuesit, ndërsa drejtuesit e Romës po mendojnë edhe diçka tjetër. Ata janë gati t'i ofrojnë 31-vjeçarit shiritin e kapitenit. Largimi i De Rossit bën që shiriti t'i kalojë Alesandro Florenzit, por edhe ky është me valixhe gati. Në një situatë të tillë, Higuaini do të ishte kapiteni i përkryer i ekipit të Romës.

#### Aletico nxjerr në shitje tre lojtarë

Aletico e Madridit ka një plan të qartë këtë verë dhe e ka nisur duke bërë gjysmën e punës. Skuadra madriline ka bërë disa spastrime dhe ka rigjeneruar grupin duke sjellë lojtarë të rinj. Por, spastrimet nuk mbarojnë me kaq, pasi klubi ka nxjerrë në merkato dhe tre lojtarë të tjerë. Siç raporton "Marca", Diego Costa, Corea dhe Nikola Kaliniq janë në shitje dhe në momentin që vjen një ofertë e majme, lojtarët do të largohen. Për Diego Costën ka interes nga Anglia, pasi Evertoni dhe West Hemi e kërkojnë. Ndërsa për Kaliniq dhe për Corean deri tani nuk ka një interes konkret. Paratë që do të merren nga shitja e këtyre lojtarëve do të përdoren për ta blerë James Rodrigezin nga Reali.

#### Davis: Krenari të luash te Lakersi dhe përkrah LeBronit

Në merkaton e çmendur dhe të paparashikueshme të NBA-së, një nga lëvizjet që, ndoshta, dihej prej kohësh, ishte kalimi i Anthony Davisit nga New Orleans Pelicansi te Los Angeles Lakersi. 26-vjeçari iu bashkua kalifornianëve për një kontratë të majme prej 27 milionë dollarësh në sezon, por kjo nuk i ka frikësuar drejtuesit e Lakersit, të cilët hoqën dorë nga Ingram, Lonzo Ball, Hart dhe tri zgjedhje të para në draft. Shtatlarti i lindur në Chicago u prezantua me fanellën e Lakersit, duke shpalosur edhe objektivat. "Kur mësova se mund të transferohesha në Los Angeles e kuptova që ishte një mundësi e mrekullueshme për karrierën time. Është një krenari të luash për Lakersin. Besoj se do të kemi një sezon entuziazmues dhe me rivalitet, sepse shumë skuadra janë përforcuar. Jam shumë i lumtur që jam këtu", ka thënë Davis.

Në "Staples Center" do ta ketë mundësinë të ndajë parketin me një prej basketbollistëve më të mirë në historinë e NBA-s, LeBron James dhe Anthony Davis nuk ka se si të mos e vlerësojë "Mbretin" James. "Do të jetë fantastike që të stërvitem dhe të luaj gjithë sezonin përkrah tij, ai është një basketbollist i jashtëzakonshëm dhe një lider i madh". Davisit e anashkaloi çështjen e rinovimit me Lakersin në fund të këtij sezoni, duke deklaruar se për momentin është i përqendruar vetëm te basketbolli.









Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Drejtoria për Arsim / Department of Education

Nr. 927/2019  
Dt. 16.07.2019

Në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 5 (shkronja c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Rep. së Kosovës Nr. 03/L-068, Neni 17 (shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Neni 35 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Rep. e Kosovës Nr. 04/L-032, neni 7 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ 10/2018 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimin të përgjithshëm, Udhëzimin administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore, Drejtoria Komonale e Arsimin në Skenderaj, shpall:

